



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, bazuar në nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.31, të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës Nr. 06/L-056 si dhe nenin 3 të Ligjit Nr. 05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, me datë 23 dhjetor 2022 miraton:

RREGULLORE Nr. 03 / 2022
PËR PRAKTIKANTË NË SISTEMIN PROKURORIAL

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kriteret, kushtet, detyrat dhe përgjegjësit si dhe procedurën për rekrutimin e praktikantëve në sistemin prokurorial.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për praktikantët, stafi i sistemit prokurorial gjatë procesit të rekrutimit dhe angazhimit të tyre.

Neni 3
Shkurtesa dhe përkufizimet

1. Shkurtesat dhe përkufizime e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin siç është përcaktuar si në vijim :
 - 1.1. **KPK** - Këshilli Prokurorial i Kosovës;
 - 1.2. **Sekretariati** - Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
 - 1.3. **Prokuroria** - nënkupton çdo prokurori e Kosovës siç është përkufizuar në Ligjin për Prokurorin e Shtetit;

- 1.4. **Praktikant i diplomuar** - nënkupton personin e kualifikuar i cili ka përfunduar studimet universitare në një institucion të arsimit të lartë të akredituar në Kosovë ose jashtë vendit;
- 1.5. **Praktikant student** - nënkupton personin i cili është duke vijuar studimet në një institucion të arsimit të lartë të akredituar në Kosovë ose jashtë vendit;
- 1.6. **Aftësimi praktikë** - nënkupton vizita studimore të studentëve të padiplomuar që zgjasin jo më shumë se 1 javë.

Neni 4

Aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale

1. Sekretariati i Këshillit Prokurorial bën thirrje për aplikim të gjithë personave të interesuar për të aplikuar për punë praktike në sistemin prokurorial.
2. Konkursi për rekrutimin e praktikantëve, mund të shpallet çdo vit në periudha të ndryshme kohore nga Sekretariati, në bazë të kërkesës së kryeprokurorit të Prokurorisë përkatëse, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit, apo sipas nevojës.
3. Konkursi është i hapur për pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes së lajmërimit dhe duhet të përmbajë informatat si në vijim:
 - 3.1. numrin e vendeve të lira;
 - 3.2. titullin e pozitës;
 - 3.3. kualifikimet e nevojshme;
 - 3.4. përshkrimin e punës;
 - 3.5. kohëzgjatjen e punës praktike.
4. Kandidatët praktikantë duhet të plotësojnë formularin standard për aplikim që është në dispozicion në ueb faqen e KPK-së.
5. Konkursi për rekrutim publikohet në ueb faqen e KPK-së dhe Prokurorit shtetit si dhe në tabelën shpalljeve të Sekretariatit dhe në prokurorinë përkatëse.
6. Konkursi për rekrutim publikohet në pajtim me ligjin për gjuhët zyrtare të Kosovës.

Neni 5 Kriteret

1. Për të aplikuar për pozitën praktikantë në sistemin prokurorial kandidatët duhet të jenë të diplomuar në fushën përkatëse.
2. Kandidatët e diplomuar të cilët aplikojnë për punë praktike duhet t'i prezantojnë dëshmitë si në vijim:
 - 2.1.kopjen e letërnjoftimit;
 - 2.2.diplomë apo certifikatë universitare;
 - 2.3.certifikatën e gjendjes penale.

Neni 6 Komisioni

1. Rekrutimi i praktikantëve të diplomuar bëhet nga një komisioni i veçantë themeluar me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së për çdo shpallje të rekrutimi.
2. Komisioni përbëhet nga 3 anëtar dhe do të ketë përbërje si në vijim:
 - 2.1.Një zyrtar nga Njesisë e Burimeve Njerëzore, njëherit është edhe kryesues i komisionit;
 - 2.2. Administrator i prokurorisë përkatëse;
 - 2.3.Një zyrtar nga prokuroria përkatëse.
3. Komisioni për rekrutim ka për detyre dhe përgjegjësi si në vijim:
 - 3.1.të shqyrtoj aplikacionet e kandidatëve;
 - 3.2.të përgatit listën e kandidatëve që plotësoj kriteret;
 - 3.3.të organizoj intervistën e kandidatëve si dhe
 - 3.4.të përgatit listën përfundimtare të kandidatëve fitues.

Neni 7 Procesi i rekrutimit

1. Procesi i rekrutimit duhet të jetë i hapur, transparent, konkurrues dhe i bazuar në parimin e meritokracisë.
2. Rekrutimi bëhet në bazë të procesit të intervistimit dhe secili kandidat për praktikant duhet të intervistohet.

3. Intervista duhet të jetë e përqendruar në pyetjet e motivimit, profesionale, njohurive të përgjithshme për sistemin prokurorial dhe perspektivës së karrierës.
4. Komisioni pas përfundimit të intervistave publikon listën e kandidatëve fituese.

Neni 8 E drejta ankesës

1. Kandidatët e pakënaqur me procesin përzgjedhjes përfundimtare kanë të drejtë në ankesë në Departamentin e Burimeve Njerëzore, brenda afatit prej 30 ditëve pas publikimit të rezultateve.
2. Ankesa shqyrtohet brenda një kohë të arsyeshme, por jo më gjatë se tridhjetë (30) ditë pas pranimit.

Neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësit e praktikantëve

1. Praktikantët e sistemit prokurorial kanë këto të drejta dhe përgjegjësi si në vijim:
 - 1.1. Ndihmon prokurorët si dhe stafin e sistemit prokurorial në kryerjen e detyrave si dhe kryen pune të tjera në koordinim me zyrtarët e prokurorisë dhe Sekretariatit të KPK-së.
 - 1.2. Përbahen rregullave të brendshme të sjelljes, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në vijueshmëri, orarin e punës, kodin e veshjes dhe konfidencialitet.
 - 1.3. Në përputhje me legjislacionin në fuqi duhet të gëzojnë të drejtën për pushim ditor, pushimin vjetor, festat zyrtare dhe mbrojtjen nga orët e tepërta të punës.
 - 1.4. Praktikanti duhet të ketë mundësinë që të aftësohet në aspektin profesional më kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të cilat i janë ngarkuar.
 - 1.5. Përgatitjen e raportin 6 mujor dhe në fund të praktikës, ose sipas kërkesës së mbykqyrësit me angazhimet e kryera.
 - 1.6. Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga prokurori si dhe zyrtarët e sistemit.
2. Përjashtimisht praktikantët të cilët janë të fushave tjera siç janë praktikant në financa, teknologji informative, administratë, burime njerëzore si dhe shërbime të

tjera të përgjithshme detyrat përcaktohen nga udhëheqësit e njësive përkatëse brenda Prokurorit të shtetit dhe në Sekretariatit e KPK-së sipas nevojës.

Neni 10 **Mbikëqyrja dhe vlerësimi**

1. Praktikantët e caktuar në sekretariat mbikëqyrën nga Udhëheqësit e njësisë ku i njëjti kryen praktikën.
2. Praktikantët e caktuar në prokurori mbikëqyrën nga Administratori i prokurorisë përkatëse.
3. Vlerësimi i punës praktike së praktikantëve bëhet në fund të përfundimit të praktikës.
4. Në raste të mosrespektimit të përgjegjësisë të përcaktuara në këtë rregullore, praktikantit i ndërpritet praktika në pajtim me ligjin e zbatueshëm dhe të njëjtit nuk mund të marrin vërtetim.

Neni 11 **Kohëzgjatja e praktikës**

Për praktikantët e diplomuar kohëzgjatja e praktikës është, jo më shumë se 1 vjet.

Neni 12 **Vërtetimi**

Me përfundimin e periudhës së praktikës, praktikantit i lëshohet vërtetimi që shkërbenë për të dëshmuar përfundimin e praktikës dhe regjistrohet në regjistrat përkatës të prokurorisë apo Sekretariatit.

Neni 13 **Bashkëpunimi me institucione tjera për rekrutimin e praktikantëve**

1. KPK nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione tjera për vizitat dhe aftësimë praktikë për studentët e padiplomuar.
2. Aftësimi praktik i studentëve të padiplomuar realizohet në bashkëpunim me institucionet tjera me marrëveshje të veçantë e cila përcakton mënyrën e bashkëpunimit.

3. Institucionet tjera parashtrojnë kërkesë tek KPK për bashkëpunim rreth aftësive praktike.

Neni 14 Kompensimi

1. Në parim, gjatë periudhës së praktikës, praktikantët nuk do të kompensohen.
2. Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, në rast të sigurimit të mjeteve financiare qoftë nga buxheti i Këshillit Prokurorial të Kosovës apo nga ndonjë partner i KPK-së, praktikantët mund të kompensohen.

Neni 15 Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2023.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje dispozitat e saj zbatohen për rekrutimin e praktikantëve për Prokurorin e Shtetit dhe Sekretariatit të KPK-së.

Prishtinë, më 23 dhjetor 2022

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

